



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2024:089076

Datë: 23.03.2024

Numri i dokumentit: 05494348

**P.nr.60/2024**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Shefqet Baleci, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Elheme Kastrati, në çështjen penale kundër të akuzuarve: L.Sh nga ..., Komuna e Drenasit, për vepër penale Lëndim i lehtë trupor, të parashikuar nga neni 185 par.1. nënpar.1.4. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe F.K nga ..., Komuna e Drenasit, për vepër penale Sulmi, të parashikuar nga neni 184 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti të Përgjithshëm PP.II.nr.6359/2023, datë.14.03.2024, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, për dhënien e urdhrin ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësorë, PP.II.nr.6359/2023, datë.14.03.2024, me datë.22.03.2024, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**PRANOHET KËRKESA E PROKURORISË THEMELORE-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM** në Prishtinë PP.II.nr.6359/2023, datë.14.03.2024, dhe gjykata jep këtë:

## URDHËR NDËSHKIMOR

### TË AKUZUARIT:

**1.-L.Sh**, i biri i ... dhe i ..., e gjinisë Dragusha, i lindur më datë ... në Prishtinë, tani e ka vendbanimin në ..., Komuna e Drenasit, me numër personal ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjës së mesme ekonomike.

**2.-F.K**, i biri i ... dhe i ..., e gjinisë ..., i lindur më datë ... në ..., Komuna e Drenasit, ku edhe tani e ka vendbanimin, me numër personal ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjës së mesme ekonomike.

## JANË FAJTORË

### I.-I akuzuari L.Sh:

**SEPSE:** më datë 15.10.2023, rreth orës 14:02 min, në fshatin ....., Komuna e Drenasit, i akuzuari L.Sh, prapakisht i provokuar me fjalë nga i dëmtuari F.K, me dashje e me qëllim të shkaktimit të dëmtimit trupor, e kishte sulmuar fizikisht të dëmtuarin F.K, në atë mënyrë që, për shkak të mosmarrëveshjes së atëçastshme, deri sa i akuzuari F.K kishte shkuar tek tavolina e të

akuzuarit L.Sh dhe i kishte thënë “pse po më shikon që disa ditë”, i akuzuari L.Sh i ishte drejtuar me fjalët: “mua sytë nuk mund me mi ndal askush dhe e ka fyer” dhe ishte ngritur dhe e kishte goditur me grushta, ku si pasojë kishte filluar përleshja fizike në mes tyre, duke e goditur njëri tjetrin disa herë me grushta dhe shkelma në pjesë të ndryshme të trupit, deri sa dëshmitarët që kishin qenë të pranishëm kishin ndërhyrë që të i ndanin, më ç’rast sipas akt ekspertimit mjeko ligjor në bazë të dokumentacionit, të përpiluar me datë 20.11.2023, nga ekspertja mjeko ligjore Dr.Bergita Curri, i dëmtuari F.K kishte pësuar dëmtime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin, në formë të ndrydhjes të indeve të buta në anën e majtë të hundës, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë të topitur,-

**-me këtë i akuzuari L.Sh ka kryer vepër penale Lëndimi i lehtë trupor, të parashikuar nga neni 185 par.1. nënpar.1.4. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

### **II.-I akuzuari F.K:**

**SEPSE:** më datë 15.10.2023, rreth orës 14:02 min, në fshatin ..., Komuna e Drenasit, i akuzuari F.K, për shkak të mosmarrëveshjes së atëçastshme, me dashje kishte përdor forcën fizike ndaj të dëmtuarit L.Sh, deri sa i njëjti duke hyrë në market ishte ndaluar tek tavolina e të dëmtuarit L.Sh, i cili kishte qenë me disa shokë, dhe pas një konfrontimi verbal, kishte filluar përleshja fizike në mes tyre, me ç’rast i akuzuari F.K e kishte sulmuar disa herë me grusht dhe shkelma në pjesë të ndryshme në trup, me ç’rast si pasojë e këtyre veprimeve të dëmtuarit L.Sh i ishte cenuar integriteti trupor,-

**-me këtë i akuzuari F.K ka kryer vepër penale Sulmi, të parashikuar nga neni 184 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,38,43,69 dhe neneve 185 par.1. nënpar.1.4. dhe 184 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neneve 495,359,360,364, 449 par.2.6. dhe par.3., 452 par.1. dhe 462 par.2. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i:

## **G J Y K O N**

**Të akuzuarit L.Sh dhe F.K, secilin veç e veç ME DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **240 (dyqind e dyzetë) €**, të cilin detyrohen të e paguajnë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**Nëse të akuzuarit L.Sh dhe F.K, në afatin e caktuar nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajnë gjobën, gjykata mund të ua zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg, secilit veç e veç, në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) ditë.**

Kur dënim me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, njëzetë (20) € gjobë llogaritet barabartë me një ditë burgim, kjo mundësi e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.3. të KPRK-së.

Nëse të akuzuarit në afatin e caktuar nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajnë gjobën, gjykata mund të zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burg. Kur dënimi me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, njëzetë (20) € gjobë llogaritet barabartë me një ditë burgim, kjo mundësi e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.3. të KPRK-së.

Nëse të akuzuarit në afatin e caktuar nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajnë gjobën në tërësi, gjykata do të zëvendësoj pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim, siç parashihet në paragrafin 3 të nenit 43 të KPRK-së. E nëse personat e dënuar e paguajnë pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajnë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të akuzuarve, në vend të shqiptimit të dënimit me burg, të e zëvendësoj dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Urdhri për punë të përgjithshme llogaritet ashtu që tetë (8) orë të punës në dobi të përgjithshme llogariten me njëzetë (20) € gjobë, kjo mundësi e tillë e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.5. të KPRK-së.

Detyrohet i akuzuari L.Sh, që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej **20 €**, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

Detyrohen të akuzuarit L.Sh dhe F.K, që në emër të paushallit gjyqësor, secili veç e veç, të paguajnë shumën prej **20 €**, këto në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

Detyrohen të akuzuarit L.Sh dhe F.K, që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimet, të paguajnë taksën në shumë prej **20 €**, këto në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

I dëmtuari F.K nga ..., Komuna e Drenasit, lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale Lëndim i lehtë trupor, të parashikuar nga neni 185 par.1. nënpar.1.4. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), e kryer nga i akuzuari L.Sh, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

I dëmtuari L.Sh nga ..., Komuna e Drenasit, lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale Sulmi, të parashikuar nga neni 184 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), e kryer nga i akuzuari F.K, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.6359/2023, datë 14.03.2024, ka akuzuar të akuzuarit: L.Sh nga ..., Komuna e Drenasit, për vepër penale Lëndim i lehtë trupor, të parashikuar nga neni 185 par.1. nënpar.1.4. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe F.K nga ..., Komuna e Drenasit, për vepër penale Sulmi, të parashikuar nga neni 184 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Poashtu ka ushtruar kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor dënim me gjobë pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor PP.II.nr.6359/2023, datë 14.03.2024, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që e vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga të akuzuarit.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmërinë për dhënien e urdhrin ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, dënim me gjobë, në vështrim të nenit 495 par.1. të KPP-së.

Gjykata duke i vlerësuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: kallëzimin penal me nr. të rastit 2023-AG-0622 të datës 16.10.2023 të SP në Drenas, raporti fillestar i incidentit 2023-AG-0622, të datës 15.10.2023 të SP në Drenas, procesverbal i marrjes në pyetje për dëshmitarin L.B, i dt.12.10.2023, i përpiluar në SP në Drenas, procesverbal i marrjes në pyetje për dëshmitarin Liron Krasniqi, i dt.16.10.2023, i përpiluar në SP në Drenas, procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin-të akuzuarin L.Sh, i dt.15.10.2023, i përpiluar në SP në Drenas, procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin-të akuzuarin F.K, i

dt.15.10.2023, i përpiluar në SP në Drenas, fotodokumentacioni i vendit të ngjarjës-pesë foto, raporti mjekësor i QKM Drenas, Shërbimi Urgjent, me nr. të prokolit 42667, datë 15.10.2023, ora 14:10, në emër të F.K dhe akt ekspertimit mjeko ligjor në bazë të dokumentacionit, të përpiluar me datë 20.11.2023, nga ekspertja mjeko ligjore Dr.Bergita Curri, konstaton se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se: i akuzuari L.Sh ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor, të parashikuar nga neni 185 par.1. nënpar.1.4. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), për të cilën vepër penale është i paraparë dënimi me gjobë ose burgim deri në tre (3) vjet, dhe i akuzuari F.K ka kryer veprën penale Sulmi, të parashikuar nga neni 184 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), për të cilën vepër penale është i paraparë dënimi me gjobë ose burgim deri në një (1) vit, ashtu që gjykata të akuzuarit i shpalli fajtorë dhe i dënoi me gjobë, secilin veç e veç, në shumë prej 240 (dyqind e katërdhjetë) €, (nëse të akuzuarit në afatin e caktuar nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajnë gjobën, gjykata mund të ua zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg, secilit veç e veç, në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) ditë), me bindjen se ky dënim me gjobë është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarve, dhe se i njëjti dënim do të ndikoi që të parandaloi të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre si dhe të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e të dëmtuarve për dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e bazoi në nenin 450 par.1. nenit 452 par.1.lidhur me nenin 449 par.2.nëpar.2.1. të KPP-së, ashtu që e detyroi të akuzuarin L.Sh, që të paguaj shumën prej 20 €, në emër të shpenzimeve të ekspertit të mjekësisë ligjore.

Vendimin që të detyrohen të akuzuarit L.Sh dhe F.K, të paguajnë, secili veç e veç, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 €, gjykata e bazoi në nenin 449 par.2.6. dhe par.3. të KPP-së, duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmërinë e procedurës dhe gjendjen financiare të akuzuarve.

Vendimin që të detyrohen të akuzuarit L.Sh dhe F.K, të paguajnë secili veç e veç, që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguajnë taksën në shumë prej 20 €, gjykata e bazoi në nenin 36 par.3. nënpar.3.1. të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, ku është paraparë se gjyqtarët me rastin e shqiptimit të sanksioneve penale për veprat penale të përcaktuar në nën paragrafi 3.1. të këtij paragrafi caktojnë edhe taksat për kompensimin e viktimave si në vijim: për veprat penale që gjykohen nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në shumë prej njëzet (20) €.

Vendimin që i dëmtuari F.K nga ..., Komuna e Drenasit, lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale Lëndim i lehtë trupor, të parashikuar nga neni 185 par.1. nënpar.1.4. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), e kryer nga i akuzuari L.Sh, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të e udhëzoi në kontest civil, gjykata e bazoi në nenin 463 par.2. të KPP-së, pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë të kësaj kërkesë.

Vendimin që i dëmtuari L.Sh nga ..., Komuna e Drenasit, lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale Sulmi, të parashikuar nga neni 184 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), e kryer nga i akuzuari F.K, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të e udhëzoi në kontest civil, gjykata e bazoi në nenin 463 par.2. të KPP-së, pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë të kësaj kërkesë.

Nga e lartëheksuara është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**P.nr.60/2024, datë:22.03.2024**

**Procesmbajtësja**  
**Elheme Kastrati**

**Gj y q t a r i**  
**Shfqet Baleci**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 496 par.2. të KPP-së. të akuzuarit mund të ushtrojnë kundërshtim në afat prej 8 ditë, nga dita e pranimet dhe kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate. Nëse kundërshtimi nuk hudhet për shkaqe të arsyeshme, atëherë gjykata do të caktoi mbajtjen e shqyrtimit gjyqësorë sipas aktakuzës së ushtruar. Nëse nuk paraqitet kundërshtimi apo paraqitet pas afatit, urdhëri ndëshkimorë merrë formën e prerë dhe ekzekutohet.